

3.3 HIDROIZOLUES ELASTOMERIK

IZOELASTIC LIQUID



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
4 kg/kovë 20 kg/kovë	60 cp/paletë 27 cp/paletë	0.8 - 1kg/m ²	E Bardhë



IZOELASTIC LIQUID është një material lyerës hidroizolues për tarraca, me përmbajtje të lartë rezinash elastomerike.

- Ofron një hidroizolim dhe elasticitet të lartë.
- Karakterizohet nga aftësi shumë të mira ngjitëse në të gjitha sipërfaqet me bazë çimento si dhe të atyre të përbëra prej tulle, druri ose metali dhe mbi çdo lloj tjetër materiali hidroizolues.
- Mundësi përdorimi dhe në shtresa ta paniveluara.
- Siguron elasticitet të lartë duke evituar formimin e çarjeve dhe plasaritjeve që mund të krijohen me kalimin e kohës.
- Ngjyra e bardhë e hidroizoluesit gjatë verës ndihmon në uljen e temperaturës, është hermetik por lejon përshkueshmërinë nga avujt.

FUSHA E APLIKIMIT

IZOELASTIC LIQUID përdoret si hidroizolues nëpër tarraca, ballkone, mure, si edhe në vënde me lagështi. Aplikohet lehtësisht duke krijuar një membranë hidroizoluese me elasticitet të lartë dhe rezistencë mekanike pa krijuar çarje ose tkurrje. Gjithashtu, është lehtësisht i aplikueshëm në zonat e vështira si kënde, bashkime të materialeve të ndryshme që formojnë fuga etj. IZOELASTIC LIQUID nuk rekomandohet të përdoret për hidroizolim dhe bodrumeve nëntokësor.

MËNYRA E APLIKIMIT / KONSUMI

Sipërfaqet ku do të aplikohet materiali duhet të jenë të pastra nga pluhurat, bojërat, etj. Në mënyrë që të arrihet një hidroizolim sa më i mirë rekomandohet që sipërfaqja që do të hidroizolohet me IZOELASTIC LIQUID të trajtohet paraprakisht me astarin HIDROPRIMER (konsumi 200 - 300 g/m²)

IZOELASTIC LIQUID aplikohet në dy duar me furçë ose me rrul, mbasi të jetë tharë plotësisht astari i aplikuar paraprakisht mbi sipërfaqen që do të hidroizolohet. Konsumi është afërsisht 0.8 - 1 Kg/m² në varësi të sipërfaqes që do të hidroizolohet. Dora e dytë duhet të aplikohet vetëm pasi astari të jetë tharë plotësisht, duhet ti kushtohet kujdes që aplikimi i dorës së dytë të bëhet në formë kryq mbi dorën e parë. Në zonat që karakterizohen nga plasaritje apo çarje rekomandohet që hidroizoluesi të përforcohet nga aplikimi i rrjetës me fibra xhami me një dendësi prej 65 - 125 gr, e cila aplikohet menjëherë mbas aplikimit të dorës së parë

të hidroizoluesit. Më pas mbi rrjetën aplikohen nga një deri në dy duar të tjera me hidroizolues. Në rastet kur sipërfaqja që do të hidroizolohet karakterizohet nga çarje dhe plasaritje të shpeshta rekomandohet që rrjeta me fibra xhami të aplikohet në të gjithë sipërfaqen që do të hidroizolohet. Në këtë rast konsumi i IZOELASTIC LIQUID shkon në 1.5 - 2 Kg/m² Duhet pasur kujdes që rrjeta e vendosur mbi sipërfaqen që do të hidroizolohet nuk duhet të krijojë tkurrje por të jetë e tendosur mirë mbi sipërfaqe.

IZOLIM LOKAL I PLASARITJEVE

Aplikojmë astarin HIDRO PRIMER në sipërfaqen e dëmtuar dhe në rreze 10 cm përgjatë plasaritjeve. Pasi thahet astari aplikojmë dorën e parë.

TË DHËNA TEKNIKE (AT 23°C AND 50% U.R)

Forma	I lëngshëm
Ngjyra	I bardhë
Densiteti	1,35 g/cm ³
Absorbimi	0,01 kg/m ² ·h0,5
Përshkueshmëria e CO2	Sd > 50m
Përshkueshmëria e avujve	Sd=0,80m
Forca ngjitëse	1,3 N/mm ²
Reagimi ndaj zjarrit	Euroclass F
Temperatura minimale e aplikimit	+5°C
Rezistenca e temperaturës	-15°C to +100°C
Viskoziteti	100.000 mPa. s



Trajtimi me HYDRO PRIMER



Vendosja e bandave elastike nëpër kënde.



Aplikimi i Izoelastic Liquid